

*Rizah Sheqiri
Nexhat Maloku
Lush Culaj*

● ●
**Për nivelin
e dytë**

PUNA DHE KOHA E LIRË



EMRI DHE MBIEMRI _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

VENDI _____

SHETETI _____



Këtë libër e gjeni edhe në versionin elektronik dhe mund ta shkarkoni nga uebfaqja e MASHT të Kosovës <http://www.mash-t.gov.net>



duk gjini

Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj

PUNA DHE KOHA E LIRË

Fletore tematike
për nivelin e dytë

duk gjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Sylja.

Hartues/e të këtij teksti: Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga
Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

Puna dhe koha e lirë në vendin ku jetoj

1. Shkolla jonë 4
2. Në shtëpinë e Drinit dhe Sarandës 7
3. Me nënën në punë 10
4. Këpucët e reja sportive 13
5. Hobby im 16
6. Notarët shpëtimtarë 19
7. Në pushimet e verës 22

Puna dhe koha e lirë në Atdhe

8. Bota e punës në Atdhe - dikur dhe sot 26
9. Papunësia si shkak për emigrim (rrëfim i gjyshit) 28
10. Bujqësia gjatë verës 30
11. Dasmat 32
12. Festimi i ditëlindjes në Atdhe 36
13. Lojëra të ndryshme në Atdhe 38
14. Në librari 40

Njerëzit dhe komunikimi

15. Si arriti njerëzimi te libri? 42
16. Gazetat dhe revistat 44
17. Radioja dhe televizori 46
18. Filmi 48
19. Komunikimi përmes internetit 50
20. Burimet e informacionit dhe besueshmëria e tyre 53



1. Shkolla jonë

Agroni dhe Laura kishin marrë një detyrë nga mësuesja e tyre për të bërë një vëzhgim nëpër klasat e shkollës dhe për të shënuar se çka punojnë nxënësit, mësuesit, drejtori si dhe shtëpiaku. Ata filluan nga oborri i shkollës. Aty bënë një fotografi të ndërtesës katërkatëshe. Afër shkollës gjendej edhe një ndërtesë më e vogël – kopshti parashkollor. Pastaj hynë në katin përdhësë të shkollës, ku së pari vizituan bibliotekën. Aty panë nxënësit të cilët huazonin libra të ndryshëm. Pastaj hynë në disa klasa. Në njërin klasë mësuesi po ua sqaronte nxënësve detyrat. Në klasën tjetër nxënësit po vizitonin duke përdorur ngjyra të ndryshme. Nëpër dollapë ishin vendosur libra dhe dosje të ndryshme me emrat e nxënësve. Në korridor shtëpiaku po rregullonte një dritare, e cila nuk mbyllej mirë. Në klasën tjetër nxënësit po bënin ushtrime në matematikë duke zgjedhur detyra me mbledhje, zbritje, shumëzim e pjesëtim. Mësuesja i kishte bërë gati zgjidhjet dhe disa prej nxënësve po bënin vetëkontroll të detyrave të tyre. Në klasën tjetër ata dëgjuan ritmet e një kënge të njohur. Nxënësit këndonin dhe njëkohësisht vallëzonin, kurse mësuesi po i binte pianos. Agroni dhe Laura shënonin të gjitha ato që mendonin se janë të rëndësishme për temën e tyre. Gjithashtu bënin edhe fotografi me pamje të ndryshme. Ata vazhduan në sallën e fizikulturës, ku nxënësit po bënin disa ushtrime. Pastaj zbritën në bodrum ku ishte një punëtori. Nxënësit po modelonin disa figura argjile.

Pasi trokitën dhe dëgjuan nga brenda fjalën 'hyni', ata u gjendën në zyrën e drejtorit të shkollës. Por, pasi ai ishte në bisedë e sipër me një mësuese, u kërkuan falje për shqetësimin dhe dolën.

- Sa shumë punë që bëhet në shkollën tonë, - tha i entuziazmuar Agroni.

- Unë kam bërë plot fotografi dhe këto do të na ndihmojnë të paraqesim para klasës portretin e shkollës sonë, - tha Laura e kënaqur.

Ata bënë një marrëveshje për kryerjen e detyrave të ndryshme para se të paraqesin temën e tyre para shokëve dhe shoqeve të klasës.

1. Bisedojmë:

Ku shkon në shkollë?

Si duket shkolla jote?

Çka të pëlqen më shumë në shkollën tënde?

2. Përgjigju pyetjeve:

1. Çfarë detyre kishin marrë përsipër Agroni dhe Laura?

2. Çfarë ndërtese gjendej afër shkollës?

3. Çka vizituan ata?

4. Çfarë po bënte shtëpiaku?

5. Pse ata dolën shpejt nga zyra e drejtorit?

6. Pse Laura kishte bërë plot fotografi?

7. Çfarë marrëveshje bënë ata?

3. Përkruaj të gjitha hapësirat shkollore të cilat i vizituan Agroni e Laura!

4. Lidh fjalët në mënyrë logjike!

Në bibliotekë
Në sallën e fizkulturës
Në oborrin e shkollës
Në klasë nxënësit
Në kopsht

dëgjojnë mësuesen.
nxënësit huazojnë libra.
shkojnë fëmijët parashkollorë.
nxënësit bëjnë një pushim.
luajnë basketboll.

5. Përshkruaj aktivitetet të cilat ti i bën në shkollë!

6. Detyre shtëpie:

- A ke shkuar ti ndonjëherë në shkollë në Atdhe?
- A e di si janë shkollat atje?
- Pyeti prindërit e tu ku kanë shkuar në shkollë në moshën e fëmijërisë dhe çka kanë përjetuar atje!
- Përgatit një rrëfim 5-minutash para klasës sate!

7. Vizato shkollën tënde!



2. Në shtëpinë e Drinit dhe Sarandës

Drini bashkë me motrën e tij Sarandën kishin një ide interesante. Ata dëshironin të bënin disa ndryshime në shtëpinë e tyre. Por ata nuk mund të vendosnin vetë, andaj biseduan me prindërit. Kur i dëgjuan idetë e tyre, prindërit u pajtuan që të fillojnë nga puna menjëherë.

- Edhe unë dhe nëna juaj do t'ju ndihmojmë, - tha babai i tyre Agimi. Para disa javësh familja e Agimit kishte gjetur një shtëpi, të cilën e kishte marrë me qira. Shtëpia kishte pesë dhoma. Kështu që ata vendosën së pari të rregullojnë një dhomë për kohë të lirë. Së pari vendosën disa kolltukë, një tavolinë dhe pastaj morën lojërat e ndryshme, që ishin lënë nëpër dhomat e shtëpisë dhe i sollën aty. Pas disa diskutimesh vendosën që edhe televizorin ta heqin nga dhoma e ditës dhe ta sjellin aty. Saranda nuk ishte shumë e pajtimit me këtë veprim, por nuk kishte ç'të bënte. Në dhomën e ditës, përpos një divani të madh, ata vunë edhe disa raftë në të cilat i renditën librat e shumtë, që i kishte familja e tyre. Agimi ishte një njeri i cili lexonte shumë e po ashtu edhe Merita, gruaja e tij. Ata ishin njohur shumë vjet më parë, kur studionin të dy gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës. Edhe pse në mërgim bënin punë, e cila nuk lidhej shumë me profesionet e tyre, ata nuk e kishin lënë anash pasionin e leximit. Saranda sikur e kishte trashëguar pasionin e tyre. Ajo, sa herë kishte kohë të lirë, lexonte libra dhe gazeta të ndryshme.

- Tash, që nuk e kemi televizorin në këtë dhomë, do të mund të flasim bashkë më shumë, - tha e gëzuar Merita.

Pasi rregulluan edhe një komodë këpucësh, babai iu drejtua Drinit.

- Drin, nëna jote dhe unë kemi menduar që të heqim kompjuterin nga dhoma jote e fjetjes. Ti kalon shumë kohë para kompjuterit edhe para se të flesh, - i tha ai.

- Por, baba mua më duhet kompjuteri në dhomë edhe për mësim, - tha Drini i mërzitur.

- Drin, ne vetëm e zhvendosim në dhomën tjetër dhe mund prapë ta shfrytëzosh kur ke për të mësuar, - iu përgjigj ai.

Gjatë ditëve që erdhën, ata u mësuan me rirregullimin e shtëpisë së tyre. Tani ata kalonin më shumë kohë së bashku. Nganjëherë shikonin ndonjë film. Drini nuk rrinte më deri vonë para kompjuterit. Kështu, ai nuk vonohej më për në mësim siç i ndodhte nganjëherë.

- Tash ne kemi një shtëpi të rregulluar shumë me shije, - tha Merita dhe i përqafoi fëmijët e saj me dashuri.

1. Bisedoni!

Si e keni të rregulluar dhomën tuaj?
Çka ka në të, me kë e ndani, çfarë pamjeje keni nga dritarja?

2. Përgjigju pyetjeve!

1. Çfarë ideje kishin Drini dhe Saranda?
2. Si e vlerësuan prindërit idenë e tyre?
3. Çka ndryshuan ata në shtëpi?
4. Cili ishte pasioni i prindërve të Drinit dhe Sarandës?
5. Çka larguan nga dhoma e Drinit?
6. Pse Drini nuk vonohej më për në shkollë?
7. Si e kalonte kohën familja pasi e rregulluan shtëpinë?

3. Plotëso tekstin!

1. Drini dhe Saranda e kishin një ide, sepse _____
_____.
2. Ata e kishin marrë shtëpinë me qira për _____
_____.

3. Prindërit vendosën të heqin kompjuterin nga dhoma e Drinit, sepse _____

_____.

4. Shto mendimet tua!

1. Po të ishe ti në vend të Drinit si do të reagoje?
2. Po të kishe kohë dhe mundësi, çka do të ndryshoje ti në dhomën tënde?

5. Lidh fjalët me ato që përshtaten!

- | | |
|-------------------------------|-----------------------|
| 1. Në kuzhinë | bëj dush. |
| 2. Në dhomën e ditës | vendos këpucët. |
| 3. Në dhomën e fjetjes | bisedoj me prindërit. |
| 4. Në dhomën për kohë të lirë | përgatit ushqimin. |
| 5. Në banjë | bie për të fjetur. |
| 6. Në paradhomë | shikoj një film. |

6. Bëjë një krahasim si banon ti këtu dhe si banojnë të afërmit e tu në Atdhe!

7. Pyeti prindërit e tu si kanë jetuar kur kanë qenë fëmijë dhe tregoni në klasë!

8. Vizatoni skica ose plane të shtëpisë/ banesës ose dhomës suaj dhe bëni një ekspozitë!





3. Me nënën në punë

Një ditë Almën e mori nëna e saj me vete në punë. Shpresa, nëna e Almës, punon shitëse në një shtëpi mallrash në qytet. Ajo është kryepunëtore në repartin e rrobave. Pasi që ishin festat e fundvitit, Kërshëndellat dhe Viti i Ri, shumë njerëz kishin dalë në qytet për të shëtitur dhe për të blerë sende të ndryshme. Edhe në katin e tretë të shtëpisë së mallrave, ku punonte nëna e Almës, kishte përplot njerëz. Disa shikonin palltot e trasha për dimër, të tjerët pantallona, xhaketa, rroba të brendshme etj. Shpesh blerësit e pyesnin Shpresën për gjëra të ndryshme, si për madhësinë e numrit të rrobave, kualitetin e shtofit dhe pastaj hynin në kabina për t'i provuar ato. Nganjëherë, kur kishte radhë të gjata të njerëzve, të cilët pritnin për të paguar rrobat që kishin zgjedhur, nëna e Almës shkonte te arka e tretë. Aty, pasi i merrte rrobat dhe i kalonte tek një vend i veçantë mbi tavolinë, ku përmes një mekanizmi hiqej një shenjë sigurie që shërbente për të siguruar sendet nga vjedhja, fillonte me shtypjen e llogarive, merrte të hollat nga blerësit dhe ua kthente atyre kusurin.

Almës i pëlqente të shikonte nënën e saj duke punuar me aq zell e kujdes. Ajo ishte e veshur me shije dhe kishte rregulluar flokët bukur. Ajo ishte shumë e sjellshme me blerësit. Pasi ua paloste rrobat e blera dhe i fuste në thasë najloni, i përshëndeste me përzemërsi duke ua uruar ditën e mirë.

Nganjëherë disa prej blerësve shkonin në një tavolinë të veçantë, ku një shitëse e re ua paketonte gjësendet e blera. Alma e kuptoi menjëherë se ato ishin dhurata për festat e fundvitit.

Përveç Shpresës aty punonin edhe pesë shitëse e një shitës. Ata u njohën me Almën dhe njëra nga to, e cila ishte gjermane, e pyeti se si po shkonte me mësim. Pastaj ajo iu drejtua nënës së Almës duke i thënë se kishte një vajzë shumë të mirë.

Kur Shpresa përfundoi me punën, e mori Almën për dore dhe shkuan në restorantin, i cili gjendej në të njëjtën ndërtesë, në katin më të lartë. Nga atje mund të shihje një pjesë të madhe të qytetit. Alma mori një pjatë me sallatë dhe një ujë mineral, kurse nëna e saj një pjatë me patate të fërguara dhe një lëng molle. Alma ishte shumë e gëzuar që e kishte përcjellë nënën e saj në vendin e punës. Tani e dinte se çfarë pune bënte ajo. Pasi përfunduan me ushqimin, ato u nisën për të shkuar në shtëpi.

1. Bisedojmë:

Cilat janë profesionet e prindërve dhe të kolegëve të tu?
Çfarë profesioneesh i njeh ti?

2. Përgjigju pyetjeve!

1. Ku shkoi Alma me nënën e saj?
2. Çfarë profesioni ka nëna e saj?
3. Pse ato ditë kishte aq shumë njerëz në qytet?
4. Çfarë i pëlqente Almës?
5. Çfarë punësh bënte Shpresa në shtëpinë e mallrave?
6. Ku shkuan Alma me nënën e saj pas përfundimit të punës?
7. Pse Alma ishte e gëzuar?

3. Plotësoje tekstin!

1. Personazhet e këtij tregimi janë _____

_____.

2. Në shtëpinë e mallrave mund të blesh _____

3. Kur dikush blen një send për dhuratë atëherë duhet _____

4. Diskuto!

1. A ke shkuar ti ndonjëherë në vendin e punës të babait apo nënës?
2. Çfarë profesione kanë prindërit e tu?
3. Cili profesion të pëlqen ty?

5. Zgjeroji njohuritë!

1. Pse të pëlqen personazhi i Shpresës?
2. Çfarë mendon ti, pse punon nëna e Almës?
3. Sa i ndihmon ti nënës në punët e shtëpisë?
Cilat punë në shtëpi i bën ti rregullisht?

6. Shpreh mendime!

1. Shumë njerëz mërgojnë në vende të zhvilluara shkaku i papunësisë në vendin e tyre. Shkruaj pse kanë mërguar prindërit e tu!
2. A di ti si është gjendja në fushën e punës në Atdheun tënd?
3. Pse shumë njerëz janë të papunë?

7. Bëje një intervistë me prindërit e tu për profesionet në të cilat ata punojnë! Shëno në fletore informacionet që ata t'i japin! Kërko edhe ndonjë fotografi që i paraqet ata në vendin e punës! Paraqite intervistën në klasë!



4. Këpucët e reja sportive

Linda bashkë me nënën e saj shkuan të shtunën në një shtëpi të mallrave në qytet. Që disa ditë Linda i ka lutur prindërit t'ia blejnë asaj një palë këpucë, të cilat i pëlqenin shumë. Dy shoqe të saj të klasës veç i kanë blerë ato. Këto janë këpucë të lehta sportive, nga një firmë e njohur, por Linda ka frikë që, kur nëna e saj të shohë çmimin e tyre, nuk do t'ia blejë. Nëna e saj është një kursimtare e madhe dhe nuk jep para shumë për veshmbathje. Por kësaj here Linda dëshiron të ketë këpucë nga firma e njohur si shoqet e saj.

Me nënën u ngjitën në katin e dytë të shtëpisë së mallrave dhe ia tregoi asaj këpucët. Kur nëna pa çmimin prej 108 € levizi dorën në drejtim të tyre sikur donte t'ia largonte. Linda e njihte atë veprim të nënës së saj. Ai donte të thoshte 'harroje këtë'. Por, kësaj radhe, Linda nuk u dorëzua. Ajo iu drejtua nënës:

- Të lutem nënë, m'ia blej këto këpucë. Më pëlqejnë shumë. Edhe shoqet e mia i kanë blerë të njëjta, - tha ajo.
- Me saq para t'ia blej tri palë këpucë në dyqanin tjetër, - ia ktheu ajo. Shitësja, që po e ndiqte këtë bisedë, ndërhyri me mirësjellje.
- Zonjë, ju vërtet me saq para mund t'ia blini tri palë këpucë diku tjetër, por këto që do vajza juaj janë shumë kualitative dhe të qëndrueshme, - tha butësisht ajo.

Linda e pa me admirim shitësen dhe iu drejtua nënës:

- Është e vërtetë kjo që thotë shitësja, nënë. Ti e di, këpucët që m'ia blen ti nuk më qëndrojnë as dy muaj, kurse këto janë të bukura dhe të forta. Këto mund t'ia bart tërë pranverën e verën.

Nëna e Lindës ra në mendime.

- Po sikur t'ia blej, - mendoj ajo me vete dhe i shikoi këpucët në këmbët e vajzës së saj. Por janë aq të shtrenjta!

- Të lutem nënë m'ia blej këto këpucë, unë po mësoj aq mirë dhe po të ndihmoj edhe ty në punët e shtëpisë, - i tha Linda.

Nëna nxori qesen dhe u drejtua nga arka. Linda tepër e gëzuar iu hodh nënës në qafë dhe e përqafoi fort duke e falënderuar.

Në mbrëmje Linda i tregoi kutinë me këpucë babait.

- Baba, shiko çfarë këpucësh më ka blerë nëna sot, - i tha ajo.

- Ua, qenkan shumë të bukura, i bartsh me shëndet bija ime! Qenkan edhe me firmën e njohur! Sigurisht janë të shtrenjta apo jo? – dhe shikoi gruan.

- Ishin shumë të shtrenjta, por ia bleva kësaj here, - tha ajo si e zënë në faj.

- Grua ke bërë mire që ia ke blerë. Na u rrit vajza tani. Ajo në të ardhmen do t'ia zgjedhë vetë gjërat që i pëlqejnë.

Kur dëgjoi këto fjalë, Linda u lumturua shumë. Edhe nëna e saj u qetësua.

Linda i përqafoi të dy prindërit dhe, pasi i mbathi këpucët sportive, doli jashtë duke kënduar nën zë.

1. Bisedojmë:

Nxënësit flasin për veshmbathjet e tyre.

Ata mund të bëjnë një listë të veshmbathjeve të cilat i kanë.

2. Përgjigju pyetjeve:

1. Pse shkuan Linda dhe nëna e saj në shtëpinë e mallrave?
2. Pse ka frikë Linda?
3. Si veptoi nëna e Lindës kur pa çmimin e shtrenjtë të këpucëve?
4. Çfarë i tha shitësja nënës së Lindës?
5. Çfarë bëri Linda kur nëna ia bleu këpucët?
6. Kujt ia tregoi Linda këpucët?
7. Çfarë i tha babai nënës së Lindës?

3. Diskutoni!

1. Çka mendon ti për dëshirën e Lindës?
2. A është e obliguar nëna t'ia blejë Lindës këpucët e shtrenjta?
3. Po ti a ke dëshirë të blesh veshmbathje me firma të njohura?

4. Shkruaj!

1. Çka mendon ti për ngurrimin e nënës së Lindës për t'ia blerë asaj këpucët e shtrenjta?

2. A të pëlqen arsyetimi që bëri babai? Pse? _____

5. Përshkruaj me gojë ose me shkrim një rast kur ti ke kërkuar nga prindërit që të të blejnë diçka që të ka pëlqyer shumë!

6. Vizato këpucët që ty të pëlqejnë!



7. Thello njohuritë!

1. Çka mendon ti, pse shumë fëmijë nuk mund të blejnë veshmbathje të shtrenjta?
2. Po shokët/shoqet në Atdhe, që ti i njeh, çfarë veshmbathjesh kanë?



5. Hobi im

Shpëtimi është nxënës i klasës së pestë. Ai gjatë kohës së lirë merret me një hobi që i pëlqen shumë, me ngasjen e biçikletës. Nëna e tij ia ka blerë një biçikletë shumë të bukur. Pastaj Shpëtimi ka blerë në postë një etiketë që tregon se biçikleta është e siguruar për një vit. Ai asnjëherë nuk del në rrugë pa e vendosur më parë në kokë kaskën. Para se të blinte biçikletën, ai ka vijuar një kurs të veçantë në shkollën e tij për të njohur shenjat e komunikacionit. Shpëtimi merr pjesë edhe në garat e çiklistëve që mbahen një herë në vit në shkollën e tij.

Por Shpëtimin më së shumti i pëlqen kur gjatë fundjavës del me prindërit e tij në natyrë. Pasi përshkojnë disa rrugë nëpër qytet, ata gjenden në një rrugë malore e dedikuar vetëm për biçikleta dhe këmbësorë. Atëherë Shpëtimi, nëna dhe babai i tij i ngasin biçikletat ngadalë dhe bisedojnë për gjëra të ndryshme. Pas një shëtitjeje të gjatë ata kthehen në banesë. I vendosin biçikletat në një vend të veçantë, i cili është i paraparë vetëm për to. Në dhomën e tij Shpëtimi ka vënë disa fotografi të tij dhe të çiklistëve të njohur në botë. Ai ëndërron që një ditë të marrë pjesë në ndonjë garë të çiklistëve. I shikon garat e tyre edhe në televizor.

Kur është koha e bukur, Shpëtimi shkon shpesh me biçikletë në shkollë. Ai e nget biçikletën nëpër rrugën që është e paraparë për çiklistë. Gjithashtu

Shpëtimi i respekton shumë rregullat e komunikacionit. Kur semafori tregon ngjyrën e kuqe, ai ndalon biçikletën dhe pret deri sa të hapet ngjyra e gjelbër. Ai sheh që nganjëherë ndonjë çiklist e tejkalon atë dhe nuk ndalet fare para semaforit, duke rrezikuar kështu sidomos këmbësorët. Në oborrin e shkollës shtëpiaku ka rregulluar një parking për biçikleta, ngase shumë nxënës vijnë me biçikleta në shkollë. Zakonisht ata janë të parët që gjenden në oborrin e shkollës, para fillimit të mësimit. Shpëtimin i pëlqen kjo kohë, sepse i takon disa prej shokëve e shoqeve me të cilët bisedon para se të bie zilha për të hyrë në klasë.

1. Bisedojmë:

Çfarë hobi ke ti?
Ku dhe nga kush e mësove?
Me kë e ushtron hobin tënd?
Cilët janë shokët/shoqet e tu/a në të?

2. Përgjigju pyetjeve:

1. Cili është hobi i Shpëtimin?
2. Çfarë vë ai në kokë para se të dalë në rrugë?
3. Ku shkon ai për fundjavë dhe me kë?
4. Çfarë ka vënë në murin e dhomës së tij?
5. Çka respekton Shpëtimi?
6. Ku e vendos biçikletën ai?
7. Çfarë bën ai para se të hyjë në klasë?

3. Mendoni dhe shkruani!

1. Cilët janë personazhet e tregimit? _____

2. Çfarë të pëlqen më shumë te Shpëtimi? _____

3. Me çka shkon ti në shkollë? _____

4. Pse i respekton ti rregullat e komunikacionit kur je në rrugë? _____

4. Vizato biçikletën dhe mundohu t'i shkruash pjesët e saj (timoni, zilja, rrotat, frenat, dritat, shpejtësitë, zinxhirët)! Mund t'i shkruash ato fjalë edhe në gjuhën e vendit ku jeton ti, nëse nuk i di shqip.

5. Përgjigjju pyetjeve me shkrim ose me gojë:

1. A del shpesh ti në shëtitje me prindërit?
2. A ke një biçikletë dhe, nëse po, kush ta ka blerë dhe sa ka kushtuar?
3. Si duhet të jetë e rregulluar një biçikletë që të kesh të drejtë të dalësh në rrugë?
4. Çka mendon ti, pse edhe çiklistët pësojnë fatkeqësi në komunikacion?
5. Çfarë mjetesh të komunikacionit ka familja jote?
Cili nga këto mjete të pëlqen ty më shumë?



6. Notarët shpëtimtarë

Genta dhe Shpëtimi e duan shume notin. Që kur ishin të vegjël, kanë mësuar të notojnë. Gentës i kujtohet kur shkonte me nënën e saj në basenin e mbuluar dhe lahej me orë të tëra në ujin e ngrohtë. I pëlqente shumë sidomos në stinën e dimrit të shihte si jashtë binte borë, kurse ajo lahej me rrobat e banjës.

Por tash ajo është rritur dhe ushtron rregullisht në klubin e notit të qytetit. Aty njohu Shpëtimin, moshatar me të. Shpëtimi e kishte banesën shumë afër liqenit të qytetit. Ata kanë kryer edhe një kurs për shpëtimin nga mbytja në ujë.

Një ditë Genta bashkë me Shpëtimin dhe disa shokë e shoqe shkuan në liqenin e qytetit për t'u larë. Koha ishte me diell dhe uji ishte i ngrohtë. Duke u larë Genta pa një fëmijë, i cili kishte hyrë thellë në ujë dhe po mendohej t'i afrohej bregut të liqenit, por pa sukses. Ai po përplaste duart në ujë dhe kërkonte ndihmë. Ajo menjëherë i tregoi Shpëtimin dhe të dy me shpejtësi u drejtuan nga fëmija. Në momentin e fundit arritën ta kapin një djalë rreth njëmbëdhjetë vjeç, të cilin e tërhoqën deri në bregun e liqenit. Djaloshi kishte pirë mjaft ujë dhe Shpëtimi përmes frymëmarrjes artificiale e ndihmoi që ai të zbrazë ujin e pirë.

Në atë moment erdhi nëna e djaloshit. Atë e kishin lajmëruar se dy të rinj e kishin shpëtuar birin e saj nga mbytja në ujë. Ajo i përqafoi Gentën dhe Shpëtimin dhe i falënderoi nga zemra.

Ajo ua mori adresat dhe u tha se do të lajmërohet përsëri.

Atë ditë në sytë e shokëve të tyre Genta dhe Shpëtimi ishin si heronj të vërtetë. Edhe ata vetë ishin të lumtur që arritën ta shpëtonin nga mbytja djaloshin e panjohur.

1. Bisedoni!

Cilat sporte i pëlqeni më shumë?

2. Përgjigju pyetjeve:

1. Cili sport i pëlqen Gentës dhe Shpëtimit?
2. Ku ushtron Genta?
3. Çfarë kursi kanë kryer Genta dhe Shpëtimi?
4. Ku shkuan një ditë ata?
5. Çfarë ndodhi me djaloshin e panjohur në ujë?
6. Si vepruan Genta dhe Shpëtimi?

3. Shkruaj për veten!

1. Me cilin sport merresh ti? _____
2. Cilët sportistë të pëlqejnë ty? _____
3. Cilat aktivitete sportive i shikon ti më shpesh në televizor _____

_____.

4. Thellim në temë

1. Cila pjesë e tregimit të pëlqen më shumë dhe pse?
2. Si e vlerëson ti veprimin e Gentës dhe Shpëtimit?
3. A ke pasur rast të ndihmosh dikë në një situatë të vështirë?

5. Vizato një pamje të një sporti që ti e do!

6. Bëje një intervistë me kolegun/kolegen e klasës për sportin që i pëlqen atij/asaj!

Ja disa pyetje (mund të shtosh edhe të tjera):

1. Me cilin sport merresh? _____
2. A ushtron rregullisht? _____
3. Kur ke filluar? _____
4. A shkon në ndonjë garë sportive? _____
5. Cili sportist të pëlqen më së shumti? _____

7. Po, kur shkon në Atdhe, me çfarë sportesh merresh?



7. Në pushimet e verës

Gazmendi ka ditë që është nën ethet e pushimeve të verës. Në fillim të korrikut, bashkë me dy motrat dhe prindërit, do të udhëtojnë për në Kosovë. Gazmendi dhe motrat e tij do të rrinë një muaj në pushim, kurse prindërit e tyre duhet të kthehen pas dy javësh, sepse duhet të rifillojnë me punën. Prindërit u kanë thënë atyre të mos mërzhiten, sepse atje do të rrinë te xhaxhai i tyre dhe do të kenë plot kushërinj e kushërira me të cilët do të kalojnë mirë.

Xhaxhai i Gazmendit ka katër fëmijë, tri vajza e një djalë. Agroni dhe Dorina janë moshatarë me Gazmendin dhe motrën e madhe Ilirjanën, kurse Zana e Fjolla janë më të reja se Shpresa.

Gazmendi, Ilirjana dhe Shpresa u kanë blerë atyre disa dhurata. Gazmendi i ka blerë Agronit një top futbollit, ngase ai e do shumë lojën e futbollit. Ata do të kënaqen duke luajtur së bashku. Ilirjana i ka blerë Dorinës një telefon mobil. Kështu, ato do të kenë mundësi të flasin e të komunikojnë përmes mesazheve. Ilirjana që katër vjet shkon edhe në shkollën shqipe në fshatin ku jeton dhe ka arritur që të mësojë aq mirë shqipen sa të mos ketë fare vështirësi për të bashkëbiseduar me të afërmit e saj në Atdhe.

Dy ditë para se të nisen për në vendlindje, babai i tyre, Xhaferi, mori një hartë të Evropës dhe i ftoi fëmijët të uleshin pranë tij. Ai filloi t'u tregojë

atyre se nëpër cilat shtete do të kalojnë me makinë. Kur ata dëgjuan emrat Itali, Austri, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi u habitën. Ilirjana mori një laps nënvizues dhe e shënoi në hartë vijën nga do të udhëtonin me makinën e tyre. Gazmendit i pëlqente shumë të bëjnë rrugë të gjata me makinën e re që e kishte blerë babai i tij para disa muajsh.

I gëzuar iu drejtua babait: - Sa shumë vende do t'i kalojmë për të shkuar në Kosovë, baba!

- Bile edhe do të shkojmë një javë të bëjmë pushim në bregdetin e Durrësit, në Shqipërinë tonë, - iu përgjigj ai të birit.

Kur dëgjuan se çfarë tha babai, Gazmendi e Ilirjana flururuan nga gëzimi. Ata filluan të ëndërronin se si do të kënaqen duke u larë në det. Atë pasdite të së shtunës filluan t'i bëjnë gati valixhet për udhëtimin e tyre për në Kosovë.

1. Bisedojmë:

Ku do të shkoni për pushime verore?

2. Përgjigju pyetjeve me gojë ose me shkrim!

1. Ku do të shkojë familja e Gazmendit në fillim të korrikut?
2. Pse prindërit do të ktheheshin pas dy javësh?
3. Sa fëmijë ka xhaxhai i Gazmendit?
4. Çfarë u kanë blerë Gazmendi dhe Ilirjana fëmijëve të xhaxhait?
5. Nëpër cilat shtete do të kalojë familja e Gazmendit për të shkuar në Kosovë?
6. Çfarë befasi kishte përgatitur babai për familjen?

3. Shkruaj!

1. Cilët janë personazhet e këtij tregimi? _____

2. Familja e Gazmendit udhëton me makinë. Me çfarë mjetesh tjera mund të udhëtohet për në vendlindje? Me çka udhëton ti zakonisht? _____

3. Çfarë dhuratash ju blini të afërmve tuaj kur i vizitoni? _____

4. Shkruaj agjencitë shqiptare të udhëtimeve që i di! _____

4. Shëno në një fletë të veçantë çfarë përgatitjesh bën kur udhëton për në vendin tënd! Mund të bisedosh edhe me shokun/shoqen e bankës. Bëje një listë praktike! Jepua prindërve dhe pyeti a ke harruar diçka!

5. Cilët prej të afërmve të tu në Atdhe i do më shumë dhe përse? Portretizoje ndonjërin prej tyre në një fletë të veçantë, ndoshta me një fotografi, dhe paraqite në klasë!

6. Bëje një listë të udhëtimeve që do të realizosh brenda një viti! Bisedo me familjen për këtë.



KËNDOJMË

Ja një këngë e bukur për stinën e verës e krijuar në frymën e këngës së bukur shqipe!

Teksti: Qamil Guranjaku
Muzika: Pranvera Badivuku

EJA, EJA, E BARDHA VERË!

Allegretto

Ne lu - li - shte mbush' me er' sa jan' t'ëm-bla she -
- ti - tjet n'ver'. Fryn ve - ri - u bil - bi - li k'ndon
zë - ri ëm - bël zem - rat na i g'zon rat na i g'zon
E - ja e - ja e bar - dha ver' si - kur er - dhe vi - tet
tier' si - kur er - dhe vi - tet tier' plot me lu - le plot me er'.



8. Bota e punës në Atdhe - dikur dhe sot

Ndryshe ishte dikur dhe ndryshe është tani.

Ara lëvrohej me qe dhe fara hidhej me dorë. Sot bëhet me makina mbjellëse dhe me traktor. Ndërsa nga fusha e teknikës dhe e teknologjisë, shumë punë sot kryhen me kompjuter. Prandaj dhe është bërë aq i nevojshëm mësimi i kompjuterit.

Gjyshi i Arianit, xha Bardhi, dikur korrte grurin me drapër. Ditë të tëra kalonte me tërë familjen duke korrur dhe duke shirë grurin, duke kositur livadhin, duke prerë dru me sëpatë, duke lëvruar me kalë a qe.

Sot ai korr grurin me kombajnë, kosit livadhin me kosë traktori, përgatit drutë për dimër me motosharrë, lëvron me traktor.

Por, xha Bardhi ndonjëherë duket i pakënaqur edhe sot. -Pse? do të pyesni.

Sepse nuk e mëson dot kompjuterin. Është tepër plak për gjëra të tilla, prandaj bëhet paksa nervoz e shan nën zë.

Xha Bardhi, kur vëren përtacinë e të rinjve sot, fshan lehtë dhe thotë:

- Eeeeeh, ç'kemi hequr ne!

Ndonjëherë Bardhi sikur mërzitet nga këto fjalë të gjyshit që ai përsërit aq shpesh.

Lehtë e ka Bardhi pasi që nuk ka provuar asgjë nga ato që thotë gjyshi.

Megjithatë, Bardhit i ngjallin dhembshuri këto fjalë dhe ia rrah shpatullat lehtë atij e i thotë.

- Të shkuara të harruara gjysh!

Gjyshi ia kthen:

- Të shkuara po, ore... veçse të harruara.... nuk e di,- dhe vë buzën në gaz.

1. Trego ose shkruaj për gjyshërit e tu:

1. Çfarë punësh bënin gjyshërit tuaj dikur?
2. Çfarë bëjnë ata sot?
3. Çka i bën të lumtur?
4. Çka i shqetëson ata?

2. Çfarë punësh bën ti në Atdhe, gjatë pushimeve?

1. A ka ngjashmëri mes punëve që bënin gjyshërit tuaj dikur me punën që bëjnë prindërit tuaj sot?
2. Cilat janë ngjashmëritë?
3. Po dallimet cilat janë?

3. Detyrë shtëpie

1. Bëje një intervistë me gjyshërit e tu, pyeti për fëmijërinë e tyre, çka kanë luajtur, punuar, ndihmuar, mësuar etj. Inçizo në magnetofon ose shëno përgjigjet e tyre.
2. Punoje një poster apo një pllakat të bukur me tekst dhe fotografi për gjyshërit e tu, përgatit një prezantim 10 minutësh për në klasën tënde!

4. Vizita në vendin e punës

1. Përshkruani një vizitë që i keni bërë nënës ose babait tuaj në vendin e punës!
2. A keni vizituar dikë në Atdhe në vendin e punës së tij? Nëse po, përshkruani atë vizitë!

5. Përshkruaj:

1. Përshkruaj sa më saktë procesin e një pune në vendlindjen tënde!
2. Cilat janë qëllimet e asaj pune, mjetet dhe mënyra se si realizohet ajo?





9. Papunësia - shkak për emigrim (Rrëfim i gjyshit)

Gjyshi po ankohej se kishte dalë shumë i ri të punonte në kurbet dhe se tashmë kishte mbetur larg atdheut.

Ai tash kishte jetë të mirë, me djem, nipa e mbesa në Gjermani, po një krimb e brente nga brenda, ndaj gjithnjë e sillte bisedën e njëjtë.

- O gjysh, po pse atëherë erdhe të punosh në Gjermani? – iu drejtuan njëzëri Vesa dhe Visari.

- Edhe pse, pyesni, - sikur priti rastin të rrëfehej gjyshi. – Që ta merrja nuse gjyshen tuaj duheshin para dhe im atë nuk kishte nga t'i siguronte i shkretëti. O të merrja rrugën e Gjermanisë, o të rrija pa u martuar, - zuri të bënte shaka ai. Pastaj rrëfeu:

- Nuk ishte vetëm puna e martesës, po atëherë nuk e siguroje dot as bukën e gojës në fshatin tonë. Në punë shteti s'hyje dot. Shkollën nuk e kisha vazhduar nga mungesa e parave, se do te mund të isha edhe unë një copë mësuesi. Se mësuesit filluan të jetojnë më mirë. Vetëm ata kishin biçikletë. Punoja ndonjë ditë si marangoz, po nuk mjaftonte. Rrallë hanim bukë gruri. Me një petë nëna gatuante tre lakrorë. Kur iu mbush mendja babit të më fejonte, atëherë tha: 'Po me se do ta marrin nusen se? Si t'ia blejmë unazën e rrobat e nusërisë? Si ta bëjmë dasmën?' Turpërohej im atë ta

merrnim nusen ashtu... si ta grabisnim. Dhe më dha leje të merrja rrugë. Erdha në Gjermani me një grup punëtorësh krahu. Gjeta punë në ndërtim-tari. Bëra ca para dhe ua dërgova në shtëpi. Së shpejti u martova, po paratë na duheshin ende, se nuk hahej gjithnjë buka thatë. Pas pesë vitesh e mora gruan, fëmijët dhe u vendosa këtu...

- Po mirë gjysh, e ç'të keqe ka që jetojmë këtu? - pyeti Vesa.

- Pooo, jeni të vegjël dhe s'e kuptoni dot, - u vrenjt gjyshi, - për ju edhe mund të mos ketë gjë të keqe se keni lindur këtu, po pyeteni këtë këtu... - tha dhe bëri me gisht nga zemra e tij.

1. Detyrë shtëpie

1. Bisedoni me të afërmit tuaj pse kanë emigruar!

2. Mbani shënime për shkaqet dhe rrethanat që i kanë detyruar ata të shpërngulen nga atdheu!

2. Përgjigjuni me gojë ose me shkrim në këto pyetje:

1. Si i kishin kushtet e jetesës në Atdhe prindërit tuaj?

2. Me çka punonin atje?

3. A kishte punë për ta?

4. Pse s'u lejohej të punonin dhe të ndërtonin jetën e tyre në Atdhe?

3. Flisni bashkë me shokët a shoqet për shkaqet dhe arsyet e emigrimit të prindërve tuaj!

4. Kuptoni dhe shpjegoni:

1. Pse daja (prindërit, axha, vëllai etj.) kanë emigruar?

2. Ku është dallimi mes emigrimit ekonomik dhe atij politik?

3. Sa është e organizuar mërgata shqiptare në vendin ku jetoni?



*Fatmir Haxhiu,
Korrja e grurit (pikturë)*

10. Bujqësia gjatë verës

Lulja dhe Drini kthehen me prindër për pushime në atdhe gjatë muajve të verës. Në fshatin e tyre buzë lumit me ujë të ftohtë, atë kohë fillojnë korrjet e grurit. Ata vrapojnë arave pas kombajnës duke mbledhur kallinjtë e grurit. Po ashtu, kopshti i gjyshërve të tyre është i mbushur me domate e speca të freskët dhe këta gjithnjë mbushin tavolinën me perime të freskëta. Aty gjen jo vetëm domate e speca, po edhe shalqi, pjepër, tranguj e çfarë jo. Është koha kur vilen frytet e punës në bujqësi.

Pas disa muajsh, kur bien gjethet dhe vilen pemët, fillon sërish lëvrimi i tokës dhe punët përgatitore për vitin e ardhshëm.

Gjatë ditëve të vapës, Lulja dhe Drini shëtisin nga ara në arë duke parë fshatarët tek mbledhin shalqinjtë, i ngarkojnë nëpër kamioneta dhe i nxjerrin në treg. Nganjëherë shkojnë t'u ndihmojnë kushërinjve të tyre për të vjelë rrush në vreshtat e bukura që s'u duket fundi. Madje, një herë, tinëz të mëdhenjve, këta të dy, bashkë me moshatarët e tyre kushërinj, e lyenin fytyrën me lëngun e rrushit dhe ndiqeshin nëpër vreshta. Sa qejf që bënin. Kopshti i gjyshërve të Lules dhe Drinit, bashkë me arat e punës, vreshtat dhe livadhet, janë si kopshti i Edenit. Prandaj ata me shumë përtesë largohen nga Atdheu.

1. Përgjigjuni me gojë ose me shkrim këtyre pyetjeve!

1. Cilat janë punët që bëjnë bujqit gjatë stinës së verës në Atdhe?
2. Sa i ndihmojnë fëmijët në punët e verës?
3. Po cilat punë kryejnë në stinën e vjeshtës?
4. Fëmijët a i ndihmojnë në këto punë dhe si?
5. Me cilat punë merren bujqit gjatë dimrit?

2. Mendo dhe trego ose shkruaj!

1. A i ndihmon dhe si i ndihmon ti të rriturit në punët e tyre të verës në Atdhe?
2. Krahaso mjetet e bujqësisë në Atdhe dhe në vendin ku ti jeton tash!
3. Me çka merren bujqit në vendin ku jeton ti tash dhe me çka në atdhe? Cilat janë prodhimet kryesore bujqësore në të dy vendet?
4. Cilat prodhime bujqësore dhe industriale të Atdheut tënd mund t'i gjesh në vendin ku jeton ti?

3. Përshkruaj në mënyrë sa më të saktë këtë pikturë!



Simon Rota,
Të korrurat (pikturë)



*Esat Valla,
Nusja (pikturë)*

11. Dasmat

- Uuu, si bëhen dasmat në Prizren!
- Ihaaa, kurrjë në Prizren si bëhen në Prishtinë!
- Jo ore, me dasma të fshatit tim nuk ka, po ç'është kjo bisedë!

Kështu flisnin tre dhjetëvjeçarë derisa po prisnin autobusin në një qytet të madh evropian. Ata sapo ishin kthyer atje nga pushimet dhe ende ishin plot me përshtypje nga “aventurat” në Kosovë. Dasmat kishin qenë të shpeshta dhe të zhurmshme; plot këngë, sirena makinash, valle...

Të shumtën e rasteve, edhe sot, kur djemtë dhe vajzat shqiptare shprehin dëshirën për t'u martuar, ata konsultohen me familjet, për të marrë pëlqimin e tyre. Pas fejesës përgatitet dasma, e cila tash ndodh edhe në ambiente të ndryshme si restorante etj. Në ditën, orën dhe vendin e caktuar fillon dasma e përcjellë me tinguj muzike dhe me valle. Zakonisht, pas drekës së dasmës, nisen dasmoret për të marrë nusen. Ata priten shumë mirë në shtëpinë e nuses dhe, pasi lozin valle e këndojnë edhe aty, e marrin nusen me vete dhe e sjellin në shtëpinë e dhëndërrit, shoqëruar po ashtu me këngë e me valle. Gëzimi i dasmës i kaplon të gjithë.

Po dikur, si bëheshin dasmat? Eh, dikur! Ato zgjasnin edhe me javë. Krushqit deheshin e këndonin, e vallëzonin të lumtur me ditë. Në Këngët e Mujit e Halilit, vera pihej me kazan dhe dasmorët, pas lodhjeve nga dasma, flinin me javë.

1. Përgjigju këtyre pyetjeve me gojë ose me shkrim!

1. A ke marrë pjesë në ndonjë dasmë ose gezim familjar tjetër?
Trego çka ke përjetuar!
2. Përshkruaj ceremonitë e kremtimit të festeve të tjera familjare!

2. Shkruaj në fletore!

1. Përshkruaje një dasmë në Atdhe! (Nëse nuk ke marrë pjesë në ndonjë dasmë, pyeti prindërit për traditën e dasmave në Atdhe.)
2. Nëse ke marrë pjesë në shumë dasma, shkruaj në fletore se cila dasmë të ka lënë përshtypje të paharrueshme dhe pse!

3. Diskutoni dhe shpjegoni!

1. Cilat janë karakteristikat e dasmës shqiptare në përgjithësi dhe të dasmës në vendlindjen e të afërmëve tu në veçanti?
2. Çka di ti për dasmat në vendin ku jeton tash? Si festohen?
3. Cilat janë dallimet kryesore midis dasmave në vendin ku jeton dhe në vendlindjen e prindërve të tu?
4. Krahaso mënyrën si organizohen dhe festohen dasmat në vendin ku jeton dhe në vendlindjen e prindërve të tu. Çka të pëlqen, çka jo dhe pse?

4. Detyrë shtëpie

1. Bëje një intervistë me prindërit e tu për dasmën e tyre!
Përgatit një rrëfim 5 minutësh, të cilin mund ta mbash para klasës!

5. Përshkrim.

Përshkruaj sa më saktë çka sheh në këtë fotografi!



DËGJOJMË, KËNDOJMË DHE VALLËZOJMË

Në traditën shqiptare të dasmave ka këngë dhe valle shumë të bukura dasmash.

Detyrë:

Gjej disa këngë dhe valle dasmash të trevave të ndryshme shqiptare (në CD, DVD apo internet). Dëgjoni ato, këndoni dhe vallëzoni me ndihmën e mësimitdhënësit apo të prindërve dhe bisedoni në klasë për veçoritë e përbashkëta dhe dallimet!

Organizoni një shfaqje në të cilën simuloni apo imitoni ritet e dasmës nga trevat e ndryshme prej nga vijnë prindërit tuaj.

Ja një këngë shumë e bukur e kompozuar nga Musa Piperku, kompozitor nga Kosova.

DASMA E MALËSORIT

I

Shtatë pal' lodra gjëmojnë malet

G'zon mal'sia shend e ver'

Dhe gëzimi sonte s'nalet

Dasm' e madhe bahet -e

Refreni:

Hej, Hej. Hej

Po martohet malësori

Çobaneshën mori

Nusja e bukur beln' e holl'

Si shqiponja n'mal me bor'.

II

Kur bjen fyelli, çiftelia

K'non rapsodi me sharki

Mir'se erdh't ju pret mal'sia

Buk e krip' zemër te mir

Refreni:

Hej, Hej. Hej

Po martohet malësori

Çobaneshën mori

Nusja e bukur beln' e holl'

Si shqiponja n'mal me bor'.

DASMA E MALËSORIT

HYRJA

(OSF. $\frac{4}{4}$)

KËNGA

TUTTI UNIS.

SITAT' PAL' LOD-RA GJË-MOJN' MALLI

G'ZON MAL'SI - A SHIEND E VLR' DITË GJË - ZI - MI SAN - TE S'NA - IET

DAS'MI MA - DITË BA - HET - LI

LOREK. TUTTI UNIS.

RIF.

HEJ. HEJ. HEJ PO MAR - TO - HET MA - IË - SO - RI

ÇOBA - NE - SHEN MO - RI NU - SJA BU - KUR BEI'N F HOLL'

SI SHI QIPO - NJA N'MAL MË BOR'

The musical score is written in a single system with a treble clef and a key signature of one flat (Bb). The time signature is 4/4. The score includes a prelude (HYRJA) and a main song (KËNGA) with a chorus (RIF.). The lyrics are in Albanian. Chords are indicated above the notes, and performance instructions like 'TUTTI UNIS.' and 'LOREK. TUTTI UNIS.' are present.



12. Festimi i ditëlindjes në atdhe

Sot është ditëlindja e Visarit, ndërsa motra e tij Vesa ka përgatitur gjithçka për t'i bërë një befasi sa me të këndshme vëllait të saj.

Shokët dhe shoqet e Visarit e kishin lënë për t'u takuar te sheshi "Nëna Tereze" në Prishtinë. Donin të blenin një dhuratë për Visarin dhe pastaj të shkonin te ai.

Në shtëpinë e Visarit ndihej nga larg një aromë shumë e mirë. Aty po përgatitej diçka e shijshme nga nëna e tij, kurse Vesa tanimë e kishte përfunduar ëmbëlsirën dhe vetëm po i vendoste qirinjtë mbi të.

Gjithçka ishte gati, kur u dëgjua zilja në derë. Visari doli të shihte te dera, ku e priti një befasi e madhe. Përnjëherësh, të gjithë shokët e shoqet filluan t'ia këndonin këngën e ditëlindjes.

Visari, shumë i gëzuar, i ftoi të hynin brenda. Filluan të vijnë mbi tavolinë edhe ushqimet. Më vonë erdhi edhe ëmbëlsira dhe Visari iu fryu qirinjve, ndërsa shokët e shoqet i këndonin prapë këngën e ditëlindjes. Pastaj ata ia ofruan Visarit dhuratat që kishin përgatitur për të. Njëri i kishte sjellë një arush, tjetri një libër, një shoqe i kishte sjellë një lloj zileje që ky ta vinte afër portës, në mënyrë që herë të hapej porta zilja të prodhonte tinguj të një melodie të këndshme si ato me fyej në Atdhe.

Muzika, vallja e lojëra të ndryshme të fëmijeve nuk munguan. Vetëm kur ra muzgu, fëmijët u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre.

Pasi të gjithë ishin shpërndarë, Visari iu tha mamit e Vesës:

- E pse kemi vetëm një herë ditëlindje në vit?

- Ha-haaa, - qeshi mami,- sepse vetëm një herë kemi lindur!

1. Mendoni dhe diskutoni!

1. Si bëhet festimi i ditëlindjes aty ku jeton ti dhe si festohet ditëlindja në Atdhe? Cilat janë dallimet dhe çka mund të jetë arsyeja për ato dallime?
2. Cilat janë dhuratat e zakonshme për ditëlindje?

2. Shkruani dhe vizatoni!

1. Shkruani për një rën nga ditëlindjet të cilën s'do ta harroni kurrë!
2. Përpiloni një listë dhuratash që i keni marrë për ditëlindjen e fundit!
3. Përpiloni një listë dhuratash që do të ëndërronit t'i merrnit për ditëlindjen tuaj të ardhshme!
4. Vizato poshtë tri dhuratat që i do së tepërmi!
5. Përshkruaj sa më saktësisht pakot e ndryshme në fotografinë poshtë!

3. Detyrë shtëpie:

Pyetini prindërit dhe gjyshërit si festohej ditëlindja në fëmijërinë e tyre! Shkruani një tekst të bukur të cilin do ta lexoni para klasës javën e ardhshme!



*Simon Shiroka,
Lojëra popullore*

13. Lojëra të ndryshme në Atdhe

Nxënësit mezi kishin pritur të përfundonte viti shkollor, që të kënaqeshin me pushimet verore, të dilnin për çdo mbrëmje të luanin në fushat e sportit atje buzë malit, te Gërmia. Topi i futbollit shihej ngado, djemtë tek hidheshin përpjetë për të shënuar në lojë basketbolli, lojtarët e tenisit tek djersiteshin duke vrapuar andej-këndeje, vajzat tek hidheshin në litarë, mes dy zjarresh etj.

Anita e Genti i dëshironin shumë lojërat në pishinë. Megjithatë, duhej kujdesur që aty, në pishinën e madhe të Gërmisë, të mos shkonin përtej kufijve të lejuar.

Kur një ditë Genti ishte habitur dhe kishte shkuar pak më larg, një nga kujdestarët e pishinës i kishte rënë bilbilit dhe e kishte qortuar ashpër:

- Hej, djalosh, kthehu menjëherë këndeje. Nuk i sheh kufizimet ti?

Genti ishte kthyer dhe kishte kërkuar falje. Ishte përhumbur në lojë dhe... nuk kishte faj – aty luheshin lojëra të bukura.



1. Mendoni dhe diskutoni!

1. Cilat lojëra i keni luajtur në Atdhe dhe cilat ju kanë pëlqyer në mënyrë të veçantë?
2. A ka dallime mes lojërave dhe lodrave në vendin ku jetoni tani dhe në vendin e prejardhjes së prindërve të tu?
3. A mund të ketë edhe lojëra të rrezikshme dhe cilat janë ato?
Çfarë kujdesi duhet pasur?

2. Organizo!

Organizo me shokët/shoqet në klasë/oborr të shkollës ndonjë nga lojërat që bën në Atdhe!

3. Përshkruaj me gojë ose me shkrim!

1. Përshkruaj lojërat që të pëlqejnë në vendlindjen e prindërve të tu dhe në vendin ku jeton tani.
2. Sajo një lojë apo lodër fantastike të cilën do ta doje shumë! Përshkruaje dhe bëje një vizatim!

4. Shkruaj në fletore!

Përshkruaj sa më saktësisht mënyrat se si luhet dhe rregullat e një loje, që ty të pëlqen shumë, dhe të cilën e luan me kënaqësi!

5. Detyrë shtëpie

Pyeti prindërit dhe gjyshërit për lojërat dhe lodrat e fëmijërisë së tyre!
Tregoj shokëve/shoqeve të klasës çfarë ke mësuar!



14. Në librari

Vesa dhe Visari u zgjuan në mëngjes, lanë fytyrën e dhëmbët dhe u ulën për të ngrënë mëngjes. Sapo e përfunduan mëngjesin, Vesa tha:

- Visar, a do të vish në librari të blejmë librat që do të lexojmë gjatë verës?
- Po, - tha Visari.

Në librari ata shkuan andej nga ishte radhitur letërsia për fëmijë. Edhe pse sytë u shkonin nga librat e ilustruar për fëmijë, ata tashmë duhej të lexonin librat që jo gjithnjë ishin të ilustruar.

- Unë do ta marr 'Robinson Kruzo' nga Daniel Defo, - vendosi Visari. Kam dëgjuar shumë fjalë të mira për këtë libër dhe e kam parë edhe një film, skenari i të cilit bazohet në këtë roman.

Vesa ende po hamendej. Dikur vendosi:

- Unë po marr dy libra: 'Shpella e piratëve' të Petro Markos dhe vëllimin e tretë të 'Hari Poterit' të Joanne K. Rowlingut.

Ata paguan librat dhe u nisën në shtëpi me plot zell, që të fillonin sa më parë leximin e tyre.

Gjatë rrugës, Vesa po e pyet Visarin:

- Si thua, mund të jetë libri për Hari Poterin më interesant se filmi?
- Nuk e di, - tha ky, - por mbaj mend që arsimtarja e letërsisë na ka thënë se, zakonisht, skenari i filmave është vetëm një pjesë e librit. Ndoshta libri mund të jetë edhe më interesant.

Vesa e shikoi librin me dashuri. Iu duk larg të shkonte në shtëpi dhe filloi të lexonte rrugës...

1. Diskutoni ose shkruani!

1. A lexon ti më shumë libra në shqip apo në gjuhën e vendit ku jeton tash?
2. Pse?
3. A ka në këtë vend libra në gjuhën shqipe; qoftë në bibliotekë, qoftë në librari?
4. Cili është libri yt i preferuar? Trego, pse pikërisht ky libër!
5. Cilët libra ke lexuar me shumë qejf më herët dhe pse të kanë pëlqyer?

2. Shkruaj në një fletë të veçantë!

1. Shkruaj së paku nga pesë fjali për dy librat e fundit që i ke lexuar!
2. Rekomandoji me shkrim ndonjë shoku/shoqeje një libër të cilin ti e do shumë!
Përshkruaj me fjalë tërheqëse përse ia vlen patjetër që edhe ai/ajo ta lexojë këtë libër!
3. Shiko me vëmendje pikturën poshtë! Sajo një tregim për këtë djalë, i cili, me sa duket, i pëlqen shumë librat! Tregimi të ketë të paktën 1 faqe.

3. Lexoje tregimin me zë të lartë para klasës!

Në Youtube ose CD dëgjoni këngën me tekst të poezisë së bukur të Dritëro Agollit “Këtu s’do jem” të kënduar nga Jonida Maliqi, Ardit Gjebrea e shumë këngëtarë të tjerë.



15. Si arriti njerëzimi te libri?

Kur njohuritë u shtuan aq shumë, sa që nuk mund të mbaheshin mend, njerëzit u detyruan të përdorin shenja e vizatime të ndryshme. Në muret e shpellave janë gjetur vizatime, që tregojnë ngjarje nga gjahu, lufta etj.

Në kohët e para, njerëzit shkruanin në objekte të ndryshme prej guri, bronzi, druri e në lëkurë bagëtish.

Në vitin 105 kinezët shpikën letrën. Që atëherë librat filluan të shkruhen në letër. Librat shkruheshin me dorë. Vetëm një libër kopjohej për disa vjet. Për shkak të kësaj mënyre të përgatitjes, libri ishte gjë e rrallë.

Që kur Gutenbergu shpiku shtypshkronjën, në shekullin XV, dhe që kur letra filloi të prodhohej prej drurit, në shekullin XIX, libri u bë pronë e një mase të gjerë njerëzish.

Sot në botë shtypen çdo vit libra në miliona kopje.

* * *

Libri është një nga shpikjet dhe thesaret më të mrekullueshme të njerëzimit. Aty ruhet çdo gjë që mësoi dhe zbuloi njeriu.

Libri është e duhet të jetë për njeriun shok i pandarë, shok që të mëson, mik që të çlodh, që të bën ta kalosh kohën e lirë në mënyrë të këndshme e të frytshme.

Libri i parë në gjuhën shqipe, që e njohim deri sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut, i botuar në vitin 1555.



1. Përgjigjuni pyetjeve vijuese në lidhje me tekstin me gojë ose me shkrim!

1. Trego si arriti njerëzimi deri tek libri?
2. Kur njerëzit u detyruan të përdorin shenja e vizatime të ndryshme dhe për çfarë?
3. Ku janë gjetur vizatimet e para?
4. Ku filluan të shkruajnë njerëzit në kohët e para?
5. Kur dhe kush e shpiku letrën?
6. Pse libri konsiderohej si një gjë e rrallë?
7. Kush e shpiku shtypshkronjën dhe në cilin shekull?
8. Në cilin shekull filloi letra të prodhohej prej drurit?
9. Cili është libri i parë në gjuhën shqipe?
10. Kush e shkroi librin e parë shqip? Kur u botua ky libër?


2. Shkruani nga disa fjali për pyetjet vijuese!

1. Pse libri konsiderohet si një nga shpikjet dhe thesaret më të mrekullueshme të njerëzimit?
2. Me shekuj libri konsiderohet si njëri nga shokët më të mirë të njeriut, pse?
3. Cila është domethënia apo rëndësia e librit për ty?

3. Mësoji këto gjëgjëza dhe tregoji në familje, shokëve e shoqeve dhe fëmijëve të tjerë!

A e gjeni
ç' është?
Rrënjë s'ka
e fletë bën.

(Libri)



Ara e bardhë,
fara e zezë,
e mbjell me dorë,
e korr me gojë.

(Letra dhe shkronjat)

16. Gazetat dhe revistat

Gazeta është një botim periodik me përmbajtje aktuale që u drejtohet lexuesve. Ato përmbajnë lajme dhe shkrime të ndryshme që janë aktuale për kohën kur ato botohen dhe shërbejnë kryesisht për informim masiv. Gazetat sipas kohës së botimit janë ditore, javore, me botim të veçantë, ndërsa sipas territorit ku shpërndahen quhen gazeta të qytetit, lokale, rajonale, shtetërore, etj.

Gazeta e parë e shtypur është botuar në vitin 1605. Gazeta e parë në gjuhën shqipe - "Albanese d'Italia" ("Shqiptari i Italisë") është botuar nga Jeronim De Rada më 23 gusht 1848 në Napoli të Italisë. Ka lloje të ndryshme gazetash; gazeta të nxënësve, studentore, partiake, fetare, gazeta të ndërmarrjeve etj. Ka edhe gazeta publicitare (reklamash). që shpërndahen falas nëpër të gjitha shtëpitë. Gazeta elektronike ose E-gazeta është po ashtu medium i shkruar që lexohet përmes internetit.

Ndërsa revistat nuk e kanë në radhë të parë qëllimin e informimit për ngjarjet e ditës, por ato në të shumtën përmbajnë shkrime të ndryshme analitike, debate, kuriozitete, tregime, lojëra, foto, ilustrime etj. Pra kryesisht shkrimet e revistave janë të atilla që mund t' i lexosh në çdo kohë. Ato për nga përmbajtja dhe dedikimi, mund të jenë tematike, por mund të jenë edhe të një spektri më të gjerë me shkrime me tema nga fusha të ndryshme.

Revistat dalin çdo javë, çdo dy javë, një herë në muaj, çdo dy muaj, çdo tre muaj etj.

'Pionieri', "Zog mëngjesi", „Mollëkuqja“, „Mirësia“, 'Doruntina' janë disa nga revistat shqiptare për fëmijë.



1. Pyetje rreth tekstit:

1. Çka janë gazetatat dhe revistat?
2. Çfarë përmbajnë gazetatat?
3. Çfarë përmbajnë revistat?
4. Zakonisht, kur botohen gazetatat?
5. Po revistat, kur botohen?
7. Kur quhet një revistë tematike?

2. Pyetje për ty: *Përgjigju me shkrim ose me gojë!*

1. Cilat gazeta i lexon ti (ose i ke lexuar më herët), qoftë shqip qoftë në gjuhën e vendit ku jeton tash?
2. Po cilat revista?
3. A ke ndonjë revistë tek e cila je abonuar?
4. A merrni në shtëpi ndonjë gazetë?
5. A lexon ndonjë revistë apo gazetë elektronike? Nëse po, cilat?

3. Detyrë:


Zgjidh edhe ti një poezi, një tregim, një kuriozitet, apo ndonjë artikull interesant nga revista të cilën e pëlqen dhe e lexon më me ëndje! Nëse është revistë në gjuhën e vendit ku jeton ti, atëherë bëje një përmbledhje të shkurtër shqip! Prezantoje poezinë, tregimin apo artikullin që ke zgjedhur para gjithë grupit ose edhe para gjithë klasës!

4. Detyra rreth revistave për fëmijë

1. Blej, ose huazo në bibliotekë, një gazetë për fëmijë e të rinj. Zgjidh një artikull, lexoje me vëmendje dy herë. Pastaj rishkruaje atë me fjalët tuaja!
2. Trego cilët artikuj të kanë pëlqyer dhe pse?
3. Zgjidh një artikull interesant dhe lexoje në orën e gjuhës shqipe për gjithë grupin!
4. Bëhu autor apo autore!

5. Informohu për adresën (postale ose në internet) e një reviste për fëmijë. Sajo një kontribut për këtë revistë (një poezi, një tregim të shkurtër, apo thjeshtë një letër për rubrikën e letrave të lexuesve), dërgoje në redaksi. Shpresojmë që të botohet!

6. Provo të bësh - ndoshta së bashku me një shok a shoqe - një fletore me humor (si Mickey Mouse ose Popeye) ose të paktën një faqe me një tregim me vizatime në stilin komik!



17. Radioja dhe televizori

Ka aparate të tilla që duket sikur të çojnë mijëra e mijëra kilometra larg. Ti rri në shtëpi dhe shikon drejtpërdrejt një ndeshje futbolli që zhvillohet në anën tjetër të globit, ose e dëgjon muzikën të cilën e ekzekutojnë muzikantët diku në një sallë operistike në një vend të largët në një kontinent tjetër ose sheh ndodhitë në male dhe oqeanë, prej të cilave të ndajnë shumë e shumë kilometra.

Mjafton të lëvizësh butonin e një radioje, apo kanalit e televizorit dhe nga një anë e botës do të gjendesh në anën tjetër në një vend e ngjarje tjetër. Po të kesh një radio, një televizor, një parabollë dhe dekoder satelitor apo vetëm një lidhje interneti, sot në çast i kapërcen të gjitha largësitë. Dhe kjo bëhet pa lëvizur nga vendi dhe pa dalë fare nga dhoma. Ç'janë këto aparate për ty? Diskuto edhe me shokët e shoqet për rëndësinë e tyre në jetën tonë të përditshme!

Sot ka qindra radio e kanale televizive edhe në gjuhën shqipe gjithandej në botë.

Transmetimet përmes internetit në mënyrë digjitale kanë bërë të mundur që edhe radio e televizioni të zhvillohen jashtëzakonisht shumë. P.sh., duke shkruar vetëm këto adresa: <http://www.rtklive.com/>, <http://www.top-channel.tv/>, <http://www.rtv21.tv/home1/>, etj. ti ke mundësinë përmes internetit të dëgjosh radio apo të shikosh drejtpërdrejt, apo edhe të rishikosh programet televizive të cilat janë emetuar më parë.

1. Diskutim (duhet përgatitur në shtëpi)

Programe dhe emisione televizive sot mund të transmetohen edhe përmes internetit.

Gjeni (si detyrë shtëpie) kanale televizive në internet, që transmetojnë emisione shkollore, programe për fëmijë ose filma dokumentarë televiziv për nxënës/e, qoftë në gjuhën shqipe, në gjuhën e vendit ku jetoni ose në anglisht, nëse e zotëroni.




Në klasë diskutoni çka keni gjetur dhe rekomandoni njëri-tjetrit kanale interesante! Ndoshta, bile, keni një lloptop dhe WLAN, kështu që mund të shihni drejtpërdrejt për çka flisni.

2. Pyetje:

1. Cilat stacione televizive i shikon ti?
2. Cilat janë programet tuaja televizive të preferuara?
Trego çka të pëlqen!
3. Në cilën gjuhë sheh ti më shumë TV? Trego pse!
4. Çfarë rregullash të përdorimit të televizorit keni në shtëpi (sa orë mund të shohësh në ditë, a ka emisione të cilat nuk duhet t'i shohësh etj.)? Çka mendon për ato rregulla?

3. Një detyrë me shkrim

1. Zgjidh një emision që e ke pëlqyer dhe shkruaj në fletore për të!
2. Sajo një skenar për një emision për fëmijë në radio ose televizion, të cilin do të dëshiroje ta inçizosh!



18. Filmi

Ti ulesh në një sallë të madhe dhe ja, papritur, shuhen dritat dhe, në një errësirë të thellë, para teje fillojnë të shfaqen njerëz e ngjarje, male e qytete, që i përkasin një bote shpeshherë të largët dhe të panjohur për ty.

Por ngjet edhe ndryshe...

Nën tingujt e muzikës ndodhin çudira. Fillojnë të kërcëjnë kukullat, dhelprat, lepurushët, kurse fluturat dhe zogjtë flasin ëmbëlsisht me njëri - tjetrin.

Ti fërkon sytë.

Mos vallë je në ëndërr?



PAK HISTORI PËR LINDJEN DHE ZHVILLIMIN E FILMIT

Filmi është njëri nga artet që shpeshherë quhet arti i shtatë.-

Disa nga llojet e filmit janë: filmi artistik, filmi dokumentar, filmi i animuar, apo vizatimor etj.

Filmi i parë u shfaq në Paris. Quhej "Dalja e punëtorëve nga puna" dhe u shfaq më 1885.

Deri në vitin 1920 filmi ishte pa zë.

Pas vitit 1930 fillon shfaqja e filmave me ngjyra.

Filmi i parë artistik në Shqipëri është filmi "Skëndërbeu – luftëtar i madh i Shqipërisë" i prodhuar në vitin 1954 në bashkëpunim me Studion e Moskës.

Filmi i parë artistik shqiptar "Tana" u prodhua nga Kino-Studio "Shqipëria e re" më 1958.

"Zana dhe Miri" është filmi i parë vizatimor i prodhuar në vitin 1975.

Ndërsa në Kosovë filmat shqiptarë filluan të prodhohen diku pas vitit 1970.





Këto janë pamje të siglave të disa filmave shqiptarë. Dy fotot e mëdha tregojnë siglat e dy filmave të njohur artistikë, kurse dy fotografitë anash janë nga dy filma vizatimorë.

1. Diskutojmë

1. Çfarë mundësish ekzistojnë për të parë filma shqiptarë?
2. A ke parë filma shqiptarë në Youtube?
Trego ose provoje njëherë!
3. Cili film shqiptar të ka pëlqyer më së shumti?
4. Cili është filmi që të ka pëlqyer më së shumti në gjuhën e vendit ku jeton ti?
5. Trego pak për aktorët që luajnë në këtë film!
6. Trego ngjarjen e filmit!
7. Trego çka të ka pëlqyer dhe çka jo në film.

2. Shkruaj në fletore!

1. Cili lloj i filmave të pëlqen më së shumti, pse?
2. Cili aktor/e është i/e adhuruari/a yt/ jote?
3. Shkruaj për aktorin tënd/për aktoren tënde të preferuar!
Përfytyro që mund të shkosh me të për darkë dhe që mund t'i shtrosh pyetje sa të duash. Sajo një intervistë dhe ilustroje shkrimin tënd me disa fotografi. Bëni një ekspozitë!

19. Komunikimi përmes internetit

Kompjuteri dhe interneti sot ofrojnë mundësi të pafundme komunikimi.


P.sh., përmes internetit mund të luash video-lojëra, mund të lexosh libra, gazeta e revista, mund të dëgjosh muzikë, të shohësh programe televizive e filma, pastaj mund të bashkëbisedosh sikur me telefon të rëndomtë apo edhe të bashkëbisedosh gjallë (video live) duke u parë në monitorin e kompjuterit me njëri-tjetrin (përmes Mesengjer-it, apo Skype-s,) etj.

Komunikimet më të popullarizuara sot për sot janë komunikimi përmes:

- E- postës
- Chat- it - Dhomës së bisedimit
- Audio dhe video bisedës.

Në internet ka edhe shumë platforma bisedimi. P.sh. Odachat.net, albatchat.ch, etj.

Ja një letër të cilën Jeta e mori përmes e-majlit nga shoqja e saj Borana në Shqipëri:



Mapar

Till: jeta@hotmail.com

Ämne: LETËR NGA BREGDETI

Infoga: Bifogade filer Office-dokument Foton Från Bing Uttryckssymboler

Messenger

Startsida
Kontakter
Kalender

LETËR NGA BREGDETI

E dashura Jeta!

Të përshëndes së largu, nga shtëpia e pushimit në bregdetin e bukur të Adriatikut. A të kujtohet ajo ditë kur u ndamë? Ne u mërzitëm, se nuk do të jemi së bashku në pushimet verës. Por ia dhamë fjalën njëra - tjetrës se do të lidhemi me letra. Dhe ja, unë po të shkruaj. Për çfarë të tregoj më parë: për shokët e rinj, për shoqet e reja, për rrezet e diellit, për ujin e detit, për lulet, shëtitjet, këngët, librat, lojërat?!

Sa bukur po kalojmë! Megjithatë, mua më merr malli për ty. Këtu njoha një shoqe. E quajnë Vjollca. Sa bukur këndon ajo! Më nxjerr mallin tënd, se dhe ti këndon bukur.

Nesër do të vizitojmë portin detar dhe do të shëtitim me vaporin "Skënderbeu". Unë do të të shkruaj gjithë përshtypjet e mia dhe besoj që do të kënaqesh, se ty të pëlqejnë shumë këto vizita. Erdhi koha që të lahemi në det. Për ne kjo është kënaqësi tjetër e madhe. Po e përfundoj letrën. Të uroj edhe ty pushime të gëzuara. Shoqet e shokët e mi të përshëndetin. Atyre u flas gjithnjë për ty.

Të përqafon me mall,

Borana

Internet 100%

1. Pyetje rreth e-majl-it që e mori Jeta. Përgjigju me gojë ose me shkrim!

1. Çfarë i ka premtuar t'i dërgojë Jetës Borana herën tjetër në e-majl-in e saj?

2. Diskutoni pyetjet vijuese, përgjigjuni pastaj me shkrim!

1. Zakonisht si shkruhej dhe si dërgohej një letër dikur?
2. Çfarë duhet të kishte ajo?
3. Kush e dërgonte atë deri në vendin e caktuar?
4. Si shkruhet një letër përmes internetit dhe si dërgohet ajo?
5. Cilat janë të mirat dhe cilat të këqijat e komunikimit me e-majle? Bëj një tabelë me dy kolona! Në njërën anë shkruaj të mirat, në anën tjetër të këqijat!

3. Detyrë shtëpie:

Shkruaj një letër përmes e-mailit një shoqes a shokut tuaj në Atdhe! A mund t'i bashkëngjitësh letrës edhe një fotografi? Nëse nuk di, pyeti shokët/shoqet si bëhet kjo!

4. Mësoni!

Përmes internetit mund të dërgohen edhe urime e kartolina. Për më tepër, kartolinat dhe urimet, mund t'i dizajnohesh vetë, sipas rastit, sipas dëshirës dhe sipas shijes. P.sh, ditëlindjen mund t'ia urosh dikujt me një kartolinë krejt personale elektronike. Ato mund të dizajnohen me ngjyra, në forma, me ilustrime a fotografi personale. Por, bashkë me këto kartolina urimi, mund të dërgoni edhe një këngë si ilustrim audio të kartolinës.

Edhe festat tjera familjare, kombëtare, fetare e shtetërore mund t'ua urosh miqve tuaj me kartolina të përgatitura në kompjuter. P.sh. Jeta, mësueses

së saj të ciklit të ulët për 7 Marsin – Ditën e Mësuesit, ia përgatiti një kartolinë të veçantë. Zgjodhi një fotografi të bukur lulesh dhe në mes vendosi poezinë "Mësuesja" të Adelina Mamaqit.

Në fillim i shkroi:

Mësuese me këto vargje dhe me këtë kartolinë elektronike, të përgatitur për Ty, të uroj nga zemra 7 Marsin – Ditën e Mësuesit!

Ju do të mund ta provoni të dërgoni një kartolinë elektronike me tekst, me foto dhe me muzikë duke shënuar dhe duke i rënë kësaj adrese:

<http://pub41.bravenet.com/postcard/post.php?usernum=3458240282>

Por faqe të tilla, ku mund të përgatisni dhe të dërgoni kartolina elektronike, mund të gjeni plot edhe në gjuhën e shtetit ku jetoni. Mjafton të kërkonti për këtë informacion në www.google.com, duke shënuar emrin ashtu siç i thonë e -kartolinës në gjuhën e shtetit ku jetoni. Mos harroni të kërkonti kartolinat që janë pa pagesë, sepse disa edhe kushtojnë para.



20. Burimet e informacionit dhe besueshmëria e tyre

Si të kërkojmë informacion në internet?

Bisedoni për besueshmërinë e burimeve të informacionit, sepse gjithçka që gjendet nga motorët e kërkimit nuk është nga burime të vërteta. Mësoni të dalloni njëanshmëritë e informacionit! Bisedoni në grup edhe me mësuesin/en për mundësinë e keqpërdorimit dhe për keqpërdoruesit e internetit për qellime propagandimi!

Ja një shembull se si funksionojnë motorët e kërkimit të informacionit në Internet.


P.sh. Ta kërkojmë tek www.google.com
„Tekste shkollore për diasporën shqiptare“.

Njëherë po kërkojmë të gjitha informacionet në Web.
Pastaj vetëm fotografitë.

Dhe ja se si duken informacionet dhe fotografitë e gjetura. Këtë tekst dhe tekste tjera për nxënësit/et e shkollave shqipe në diasporë mund t' i gjejmë në adresën: <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=1354>

MOS HARRONI!

Gjithë informacioni i gjetur nuk është ai që ne e kërkojmë dhe që duam ta përdorim.



Mendoni, diskutoni në klasë dhe me prindërit!

1. Pse duhet të bëjmë kujdes ndaj informacioneve në internet (por edhe në disa gazeta!)?
2. Kush mund të ketë interes për të falsifikuar informacione? Mendoni për raste konkrete dhe si duhet të mbrohemi?
3. Provoni a mund të gjeni një ngjarje për të cilën tregojnë shumë faqe në internet ose shumë gazeta; krahasoni çka shkruhet në uebfaqet e ndryshme. A ka diçka që ju bie në sy?

Detyra për punën në kompjuter/internet (punë veç e veç ose në grupe me dy)


1. Mendo për një temë të veçantë, mundësisht në lidhje me ilirët ose shqiptarët!
2. Kërko informacione në internet: a) në uebfaqe shqip, b) në uebfaqe në gjuhën e vendit ku jeton ti!
3. Kërko edhe në anglisht apo në gjuhët tjera dhe do të jetë shumë interesante!

Detyra për punën me gazeta

Informacionet mund të merren edhe nga gazetat. Ka gazeta llojesh të ndryshme dhe me prirje të ndryshme.

1. Merr dy gazeta (njërën në gjuhën e vendit ku ti shkon në shkollë dhe tjetrën në gjuhën shqipe) dhe krahaso!
2. Në tabelën më poshtë, me ndihmën e mësueses/it apo të prindit, sajo një listë gazetash në shqip dhe në gjuhën e vendit ku jeton.

GAZETA SHQIP	GAZETA NË GJUHËN TJETËR



Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj
PUNA DHE KOHA E LIRË
Fletore tematike - për nivelin e dytë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 *kopje*

Formati: 205x285

U shtyp në prill 2012

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18:37(0761)

008(=18)

Sheqiri, Xhevat

Puna dhe koha e lirë: fletore tematike për nivelin e dytë /
Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj. - Botimi i parë. - Pejë:
Dukagjini, 2012. - 56 f.: ilustr. me ngjyra; 28 cm.

1. Maloku, Nexhat 2. Culaj, Lush

ISBN 978-9951-05-250-4

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 813-304, të datës 14.02.2012.*